

Nr. 15 prot.  
Tiranë, më 7/02/ 2025

Nr. 26 10 prot.  
Shkodër, më 07 02 2025

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Projekti: “Të fuqizuar - Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara (PAK), bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal në Ballkanin Perëndimor”

përfaqësuar nga

**Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK)** me seli në Tiranë, me adresë në Rruga e Bogdanëve, nr 19, Tiranë, rregjistruar si person juridic, Fondacion me nr. vendimi 176, datë 18.10.1996, me nr. NIPT dentifikimit: K22424002D, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Znj. Blerta Cani Drenofci, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, këtej e tutje Autoriteti Zbatues.

Dhe

**Bashkia Shkoder**, me seli Rr.”13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga Z. Benet BECI , Kryetari i Bashkisë Shkodër; i përfaqësuar në këtë memorandum me Vendim Delegimi nr. 755, datë 31.12.2024 “Për delegim kompetence” nga Zv/Kryetari z. **Onid Bejleri**, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, në vijim – Bashkia Partnere

\*të dyja të përshkruara si Palë



## Hyrje

Projekti “Të fuqizuar – Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara (PAK), bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal në Ballkanin Perëndimor” është një projekt i financuar nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – BMZ dhe po zbatohet nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK) me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund – ASB. Projekti ka filluar më 1 shtator 2024 dhe do të zbatohet deri më 30 prill 2028.

Projekti synon që personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor të forcojnë pozicionin e tyre përmes dialogut dhe avokimit rajonal, praktikave më të mira dhe mbështetjes së përbashkët të zhvilluar nga komuniteti për personat me aftësi të kufizuara.

Që personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor të përdorin forume rajonale për dialog, rrjetëzim dhe mjete të krijuara në kuadër të projektit për të shprehur nevojat e tyre në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal, për të shkëmbyer praktikat më të mira në aspektin e partneritetit publik-privat-civil dhe të vendos themelet për (ri)strukturimin e fondeve të investimeve sociale për të mbështetur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

### Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është të sigurojë një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet palëve, duke përshkruar përgjegjësitë dhe angazhimin e ndërsjellë, në dobi të një zbatimi të suksesshëm të Projektit.

### Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) do të përfitojnë drejtpërdrejt nga projekti: 100 persona me aftësi të kufizuara do të përfitojnë nga përmirësimi i shërbimeve, infrastrukturës dhe mbështetjes së krijuar nga të paktën dy (2) Projekte Përfshirëse Lokale; 20 persona me aftësi të kufizuara marrin këshillim psikosocial dhe/ose për karrierë përmes seminareve të përfshirjes; 20 persona me aftësi të kufizuara rrisin potencialin e tyre të punësimit nëpërmjet ofrimit të programeve të trajnimit të arsimit profesional dhe të integritimit në punë.

Fushat e bashkëpunimit përshkruhen përmes komponentëve të projektit të cilat parashikohen të zbatohen në kuadër të kësaj nisme:

#### Komponenti 1. Zbatimi i projekteve përfshirëse lokale për persona me aftësi të kufizuara

Projektet Përfshirëse Lokale do të përmirësojnë infrastrukturën dhe shërbimet në nivel lokal për personat me aftësi të kufizuara dhe në këtë mënyrë do të promovojnë integritimin e tyre në komunitet. Mesatarisht dy projekte përfshirëse lokale priten të zbatohen në Bashkinë Partnere. Përmirësimi i aksesueshmërisë, shërbimit të zhvillimit social dhe/ose pajisjeve në mënyrë që të përmirësohet integritimi për të paktën 100 persona me aftësi të kufizuara. Komuniteti do të nominojë të paktën 2 projekte të cilat do të financohen.

## **Komponenti 2. Këshillim për karrierë dhe mbështetje psiko-sociale për persona me aftësi të kufizuara**

Personat me aftësi të kufizuara do të përmirësojnë kapacitetet e tyre për punësim nëpërmjet këshillimit për karrierë dhe këshillimit të programit psikosocial. Kjo shtyllë e aktivitetit synon të ofrojë mbështetje sociale, psikologjike dhe këshilluese për 20 persona me aftësi të kufizuara dhe të rrisë të kuptuarit e tyre për të drejtat e tyre për të pasur akses në shërbimet e disponueshme.

Në nivel grupi, të paktën 60 punëtorë gjithëpërfshirëse, secili me 10-15 pjesëmarrës do të organizohen afërsisht dy herë në muaj. Punëtoritë e përfshirjes do të organizohen nga ekipe bashkëpunëtorësh të jashtëm të përbërë nga ndërmjetës social, asistent pedagogjik, psikolog, mësues, edukator, profesionistë në punë me persona me aftësi të kufizuara etj.

Në nivel individual, si shtesë e punëtorëve, anëtarët e ekipit të përfshirjes do të kryejnë këshillim individual, orientim në karrierë dhe mentorim personal për të paktën 20 persona me aftësi të kufizuara që të jenë të gatshëm dhe të aftë për jetë të pavarur (këta do të marrin pjesë gjithashtu në punën në grup). Këto konsultime do të mbahen gjatë gjithë jetës së projektit në bashkinë partnere dhe do të përfshijnë mesatarisht 15 orë konsultime të personalizuara për individ. Ekspertët e përfshirjes do të zhvillojnë një plan zhvillimi personal për çdo person që merr pjesë në këshillimin individual dhe do të ndjekin nga afër secilin person gjatë gjithë projektit.

## **Komponenti 3. Programet e trajnimit të arsimit profesional dhe integritit në punë për persona me aftësi të kufizuara**

Personat me aftësi të kufizuara do të përmirësojnë kapacitetet e tyre për punësim përmes trajnimeve dhe programeve për integritet pune. Programi i trajnimit të arsimit profesional & integritit në punë përgatit përfituesit për të punuar në punë të ndryshme si: tregti ose zeje (p.sh. marangoz, saldator, etj.) ose thjesht për të organizuar një program integritit në punë për përfituesit që nuk janë në gjendje të punojnë. Ekspertët dhe/ose organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuara me licencat e nevojshme do të angazhohen për të ofruar trajnime për përfituesit. Ekspertët do të ofrojnë shërbime të arsimit dhe formimit profesional për përfituesit. Ekspertët do të jenë përgjegjës për organizimin e të gjitha trajnimeve të arsimit profesional - pjesët teorike si dhe praktikën brenda kompanive apo organizatave të përshtatshme.

## **Komponenti 4. Formulimi i planeve përfshirëse lokale**

Nëpërmjet këtij aktiviteti, projekti synon të analizojë dokumentet ekzistuese, konsultimet, fokus grupet, intervistat me palët e interesuara, hartimin e draft dokumenteve etj. Zhvillimi i Planeve përfshirëse lokale do të kryhet nga stafi i caktuar nga komunitetet e synuara me mbështetjen e partnerit të projektit dhe ekspertët e jashtëm.

Partneri i projektit në partneritet me autoritetet lokale në Bashkinë partnere do të iniciojë rishikimin ose përditësimin e planeve ekzistuese të veprimit lokal të fokusuar në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Do të formohet ose forcohet një grup pune në nivel bashkie për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

## **Komponenti 5. Trajnim për palët e interesuara lokale dhe zhvillimi i planeve përfshirëse lokale për personat me aftësi të kufizuara**

Të gjitha projektet do të zhvillohen së bashku dhe ky proces do të lehtësohet në Bashkinë partnere, nga partneri i projektit dhe grupi i punës në nivel bashkie, i formuar për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Ekipi lokal në komunitetet e synuara do të marrë pjesë në një trajnim intensiv 5-ditor të bazuar në raste mbi menaxhimin e ciklit të projektit, gjatë të cilit do të planifikohen projekte përfshirëse lokale. Secili ekip do të formulojë 3-5 projekt-ide të shkurtra në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe planet përfshirëse lokale të miratuara/rishikuara.

### **Neni 3. Përgjegjësitë e autoritetit zbatues**

Në përputhje me komponentët dhe rezultatet e pritshme të përshkruara në Nenin 2, Autoriteti Zbatues do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve duke:

- Ofrimi i asistencës profesionale për përfituesit e projektit dhe Bashkitë partnere.
- Sigurimi i rritjes së aftësive të personave/përfituesve të projektit në një nivel të kënaqshëm.
- Prezantimi i një niveli të lartë transparence dhe paanshmërie.
- 

### **Neni 4. Përgjegjësitë e bashkisë partnere**

Bashkia Partnere do të sigurojë se ka një nivel dhe cilësi të mjaftueshme informacioni, i cili do t'i ofrohet Autoritetit Zbatues, për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të Projektit.

Në rastet kur ka një nevojë të tillë, Bashkia Partnere do të sigurojë personelin e saj për të siguruar një zbatim të qetë të aktiviteteve të Projektit.

### **Neni 5. Natyra jashtëkontraktore e marrëdhënies**

Palët bien dakord që kjo MB përfaqëson mirëkuptimin e ndërsjellë dhe nuk ka për qëllim dhe nuk do të konsiderohet të jetë një kontratë dhe nuk do të lindë asnjë të drejtë dhe detyrim sipas një kontrate.

Asgjë që përmbahet këtu nuk do të interpretohet se përbën një partneritet të sipërmarrjes së përbashkët ose organizatë biznesi formale të çfarëdo lloji midis Palëve ose në këtë mënyrë që të përbëjë njërën nga Palët si agjent të tjetrës.

Palët pranojnë se kjo MB në asnjë mënyrë nuk krijon asnjë të drejtë ose leje për të përdorur ose për t'u lidhur me pronësinë intelektuale të secilës palë.

### **Neni 6. Data e hyrjes në fuqi**

Kjo MB do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë deri më 30 Prill 2028 që përfaqëson edhe ditën e fundit të zbatimit të Projektit.

### **Neni 7. Ndërprerja**



Secila palë mund ta ndërpresë këtë MB duke i njoftuar palës tjetër me shkrim, tridhjetë (30) ditë përpara. Në rast të përfundimit të pjesshëm, një njoftim i tillë do të specifikojë se cilat fusha të ndihmës preken.

### Neni 8. Gjuha

Ky MB është përgatitur në katër kopje origjinale, dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe. Autoriteti Zbatues do të mbajë një origjinal në anglisht dhe një origjinal në gjuhën shqipe, ndërsa Bashkia Partnere do të mbajë një origjinal në gjuhën shqipe.

### Nënshkrimet:

**PËR  
BASHKINË SHKODËR**

**KRYETAR**

**Z. Benet Beci**

**ME VENDIM DELEGIMI  
ZV/KRYETAR  
Onid Bejleri**



**PËR FShDPAK**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Znj. Blerta Cani Drenofci**

